



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 25, datë 27.01.2020

PËR CAKTIM NË POZICION TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Ylli Pjetërnikaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Z. Ylli Pjetërnikaj do të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përkohësisht nga data 27.01.2020-26.04.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Pjetërnikaj do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
4. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Ylli Pjetërnikaj, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
ARBEN DOLLAPAJ

ANËTAR
BUJAR SHËSHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
BESNIK CANI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI